


Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Vendimi Nr.05/24
Datë: 16.01.2024

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbledhjen e datës 16.01.2024, mori këtë;

V E N D I M

I. LEJOHET. Përqendrimi i ndërmarrjeve lidhur me marrjen e kontrollit të përbashkët mbi Duffle Travel Retail Platform GmbH nga GHARAGE Ventures GmbH, Dufry International AG dhe JET Cetral Core.

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në përputhje me nenin 18 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë; 09.11.2023, me Nr. Prot. 537/23-11/H ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit lidhur me marrjen e kontrollit të përbashkët mbi kompaninë JV Duffle Travel Retail Platform GmbH nga GHARAGE Ventures GmbH, Dufry International AG dhe JET Central Core.

Procedurat e ndjekura:

1. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 19.12.2023
2. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 22.12.2023
3. Palët kanë lidhur Marrëveshjen lidhur me marrjen e kontrollit të përbashkët mbi Duffle nga GHARAGE, Dufry International dhe JET Cetral Core.

Baza juridike;

Sipas nenit 13, të Ligjit nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, nga dokumentacioni i prezantuar në dosjen e lëndës, palët përmbushin detyrimin për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që;

- a) Qarkullimi i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumë më 20,000,000 Euro.
- b) Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumë më 1,000,000 Euro.
- c) Parashtruesit e kërkesës kanë për qëllim të ekzekutojnë Marrëveshjen lidhur me krijimin e një ndërmarrje të përbashkët JV (joint venture) me funksion të plotë.
- d) Kërkesa për përqendrim, është bërë për arsye se njëri ka Aplikuesit (GH Group) ka tre entitete të regjistruar në Republikën e Kosovës.

GHARAGE Ventures GmbH, ndërmarrje e regjistruar në regjistrin komercial të Gjykatë Lokale të Hamburgut në Gjermani, me numër të regjistrimit HRB 172629, me adresë të biznesit në Shanghaiallee 9, 20457 Hamburg, Gjermani. GHARAGE është në pronësi të Gebr. Heinemann SE & Co. KG, me selinë e saj të regjistruar në Koreastraße 3, 20457 Hamburg, Gjermani, e regjistruar në Gjykatën Qarkut të Hamburgut me numër të regjistrimit HRA 15017 (GH, së bashku me kompanitë e saj të ndërlidhura GH Group. GHARAGE investon dhe bashkëpunon me startup-et në fazat e hershme të tyre që angazhohen brenda ekosistemit të udhëtimit dhe shitjes me pakicë. GH është një biznes familjar me bazë në Hamburg që operon dhe furnizon dyqanet pa taksa apo Dyqanet e udhëtimit që gjenden në aeroporte, porte detare dhe pika kufitare në mbarë botën. GH operon me 350 pika të shitjes me pakicë të udhëtimeve në 73 aeroporte ndërkombëtare, të cilat funksionojnë përmes marrëveshjeve të koncesionit ose qirasë me operatorët e aeroportit. GH Group ka tre entitete të regjistruara në Kosovë, të cilat kanë selinë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës.

1. Unifree Kosovo Sh.p.k. me numër unik;810814807,1
2. Unifree Kosovo Aeroport Sh.p.k me numër unik 810711392,2
3. Unitat Kosovo Retailing L.L.C. me numër 810711417.3

Dufry International AG, ndërmarrje e regjistruar në regjistrin komercial të qytetit të Baselit, Zvicër me numër të regjistrimit CHE 102.735.389, me adresë të biznesit në Brunngaesslein 12, 4052 Basel. Dufry International është një degë e Dufry, ku që të dyja së bashku janë kompani të ndërlidhura me kompaninë Autogrill S.p.A. ("Autogrill"), një biznes global me pakicë udhëtimesh që operon pikat e shitjes me pakicë në aeroporte dhe qendra të tjera transportit, dhe një ofrues global i shërbimeve të ushqimit dhe pijeve tek udhëtarët. Dufry është i listuar në bursën zvicerane (SIX) në Cyrih, Zvicër. Aksionari kryesor në Dufry është familja Benetton (22.54%), kurse aksionarët e tjerë përfshijnë Advent International (7.1%) dhe familjen Rupert (4.9%). Asnjë nga aksionarët nuk ka ndonjë të drejtë vetoje që do të jepte kontroll pozitiv ose negativ në kompani. Dufry është një kompani zvicerane aktive në Amerikën e Veriut, Amerikën e Jugut, Evropë, Azi-Paqësor, Lindjen e Mesme dhe Afrikë që operon mbi 5,500 dyqane në 75 vende. Dufry nuk ka asnjë subjekt të regjistruar dhe as nuk ka gjeneruar qarkullim në Kosovë në vitin 2022.

JET Central Core, kompania është degë e Just Eat Takeaway.com N.V Holandë, me seli në regjistruar në Piet Heinkade 61, 1019GM Amsterdam, Holandë, me numër të regjistrimit të

Autoriteti i Konkurrencës

Adresa: Rr. Migjeni nr. 21, 10000 Prishtinë. Kati i VI, zyra Nr.1
Tel: +383 /0/ 38 200 109 82 E-mail: info.konkurrenca@rks-gov.net

biznesit 08142836. JET operon në tregun e internetit/online në ofrimin e ushqimit e që lidh konsumatorët me restorantet dhe partnerët e tjerë përmes platformave të tij.

Duffle Travel Retail Platform GmbH ("Duffle") e regjistruar në regjistrin komercial të Gjykatës Lokale të Charlottenburg, Gjermani, me numër të regjistrimit HRB 238141 B, me adresë të regjistruar në Straßburger Straße 55, 10405 Berlin, Gjermani.

Duffle aktualisht është në pronësi dhe nën kontrollin e GHARAGE e cila mban 92.5% të aksioneve ku pas ekzekutimit të këtij transaksioni ka për qëllim transformimin e së njëjtës në një kompani të përbashkët ("JV" ose "**Kompania e Përbashkët**") e cila do të kontrollohet bashkërisht nga GHARAGE, Dufry International dhe JET Central.

Tregu Relevant:

Tregu i produktit: tregu për shërbimet online dhe shërbimet e shpërndarjes në aeroporte.

Tregu gjeografik: është tregu ndërkombëtar pasi që kompania e përbashkët- JV do të jetë aktive dhe funksionale në aeroportet që gjinden në zonën BE-së, EFTA-s, Mbretërisë së Bashkuar dhe në Turqi.

Analiza e konkurrencës

Transaksioni i propozuar nuk ngritë ndonjë shqetësim për konkurrencën. Duke pasur parasysh që, as GH dhe as Dufry nuk janë konkurrentë aktualë apo potencialë në këtë treg. E njëjta gjë vlen edhe për JET: Nuk është aktive në tregun online ose shërbimeve të shpërndarjes në aeroporte. JET gjithashtu nuk është një konkurrent i mundshëm në këtë treg pasi kjo është një fushë e specializuar në të cilën JET nuk ka plane të operojë. Operacionet komerciale në aeroporte – duke përfshirë shpërndarjen e produkteve tek konsumatorët – funksionojnë në kushte krejtësisht të ndryshme nga operacionet standarde të shpërndarjes (ushqimit). Ofrimi i shërbimeve brenda aeroporteve do të kërkonte investime të konsiderueshme për shkak të kërkesave unike të ofrimit të shërbimeve në zonën ajrore shumë të siguruar në aeroport, kjo është edhe arsyeja pse praktikisht asnjë konkurrent i JET nuk është aktiv brenda aeroporteve brenda BE-së ose tregjeve të tjera të mëdha globale.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se palët në përqendrim janë prezent në Republikën e Kosovës përmes 3 filialeve në Aeroportin e Prishtinës. Mirëpo duke pasur parasysh që tregu përkatës i produktit ka të bëjë me një treg të sapolindur dhe në zhvillim i cili aktualisht nuk ekziston në Kosovë, transaksioni nuk do të ngrijë ndonjë shqetësim për konkurrencën në Kosovë. Kjo pasi që nuk ka ndonjë efekt në tregun përkatës, veçanërisht duke pasur parasysh se JV (joint venture) nuk është planifikuar të ofrojë shërbimet e saj në tregun kosovar.

Sipas vlerësimit të përqendrimit, nga ky transaksion nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës. Nga të dhënat e ofruara konsiderojmë se implementimi i transaksionit nuk do të kenë efekt negativ në tregun kosovar, e rrjedhimisht nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në tregun përkatës.

Autoriteti i Konkurrencës

Adresa: Rr. Migjeni nr. 21, 10000 Prishtinë. Kati i VI, zyra Nr.1
Tel: +383 /0/ 38 200 109 82 E-mail: info.konkurrenca@rks-gov.net

Komisioni i Konkurrencës ka vlerësuar se ky transaksion, nuk do të paraqesë efekte negative në konkurrencë, për arsye se ky transaksion /blerja nuk ndikon në forcimin e pozitës dominuese të ndërmarrjes blerëse tek operatorët ekonomik apo konsumatorët.

Shënim:

Çdo formë e shtrebbërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti – konkurruese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Kërkesa për Përgendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Neimë Binaku-Isufi
Kryetare



Kaltrina Sela
Zv. Kryetare

Nafije Osdautaj
Anëtare

Florent Mehmeti
Anëtar

Salihe Gashi-Loku
Anëtare

III. Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva